




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.34, datë 19.12.2024

PËR



**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
SIPËRFAQËSORPËR PRODHIM HIDROENERGJETIK, HEC
“GIZAVESH” TË SHOQËRISË “DARDANIA GREEN ENERGY”
SH.P.K., NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 2639, DATË 10.07.2024,
TË GJYKATAS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË
TIRANË**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, në vijim të njohjes me vendimin nr. 2639, datë 10.07.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqëria “Dardania Green Energy” sh.p.k, sipas Vendimet nr.2639, datë 10.07.2024, të Gjykatës administrative të Shkalles se Pare Tiranë, për hec “Gizavesh” me vendodhje Librazhd, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.



2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC GIZAVESH

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujq Zalli i Qarrishtës

- $X=532347.32$; $Y=4570330.89$; $Z=626$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: $0.36 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore: $3.28 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike: $0.53 \text{ m}^3/\text{s}$

Vendndodhja e godinës së Centralit

- $X=530258.09$; $Y=4567181.83$; $Z=440$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: $0.36 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prodhimi vjetor i parashikuar: $1.923.000 \text{ kwh/vit}$
- Fuqia e instaluar: 600 kwh
- Vlera totale e investimit: $479.814,74\text{Euro}$.

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujtime dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBUSHKUMBIN

ALI MYSLIU

